



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr.240 , datë 24.10.2019

PËR

**KUALIFIKIMIN E KANDIDATIT Z.{...}
DHE VIJIMIN E PROCEDURËS SË EMËRIMIT SI GJYQATAR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 24.10.2019, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për emërim si magjistrat, profili gjyqtar, të kandidatit z.{...}”, përgatitur nga relatori z.Illir Toska, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për kualifikimin e kandidatit z.{...} dhe vijimin e procedurës së emërimit të tij si gjyqtar,

VËREN

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Z.{...} është kandidat për emërimin si magjistrat, profili gjyqtar, në kushtet kur është përfshirë në listën e të diplomuarve për kandidatët gjyqtarë në përfundim të vitit akademik 2018-2019, përcjell nga Shkolla e Magjistraturës me Shkresën nr.625 prot., datë 03.07.2019, protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 3596 prot., datë 03.07.2019.

2. Me Vendimin nr.103, datë 05.07.2019, mbështetur në nenin 35 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (më poshtë referuar si Ligji i Statusit), si dhe në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për emërimin si magjistrat, profili gjyqtar, për kandidatët e diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në përfundim të vitit akademik 2018-2019, duke caktuar relatorin për çdo procedurë verifikimi për secilin kandidat, ku në bazë të shortit, për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatin z.{...} si relator u caktua z.Illir Toska.

3. Më datë 05.07.2019, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidati z.{...}, në rrugë elektronike, u njoftua: - për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit; - për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; - për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi. Po ashtu, kandidati u njoftua edhe për detyrimin për plotësimin e formularit deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj tij, formular ky që i është bashkëngjitur njoftimit.

4. Brenda afatit treditor, kandidati z.{...}, depozitoi rregullisht të plotësuar formularin deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj tij. Nga ana tjetër, në këtë afat, kandidati nuk parashtrroi asnjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

5. Më datë 08.07.2019, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidatit z.{...}, në rrugë elektronike, iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej tij në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit.

6. Brenda afatit pesëditor, kandidati z.{...}, depozitoi në zyrën përkatëse të Këshillit formularët dhe autorizimet përkatëse, ndërsa brenda afatit 21 ditor (sipas pikës 4, Seksioni A, Kreu IX, të Vendimit 75/2019), ai dorëzoi rregullisht edhe formularin “Deklaratë e pasurisë dhe interesave privatë të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë” pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë referuar si ILDKPKI).

7. Në vijim të procedurës së verifikimit, më datë 09.07.2019, kandidatit z.{...}, në rrugë elektronike, iu kërkuan të dhëna mbi punësimin/et e tij. Brenda të njëjtës ditë kandidati, në rrugë elektronike, informoi se nuk ka qenë asnjëherë i punësuar.

8. Në këto kushte, pas marrjes nga kandidati të informacionit si më sipër, ndërsa edhe nga informacionet e marra nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore (siç do të përshkruhet më poshtë) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (siç do të përshkruhet më poshtë) nuk rezultoi ndonjë e dhënë për punësimin e kandidatit z.{...}, u çmua të mos kërkohej informacion në lidhje me disiplinën në punë të këtij kandidati.

9. Gjatë procedurës së verifikimit, në datat 10.07.2019, 11.07.2019 dhe 26.07.2019, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkuar informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, përcaktuar në nenin 32 të Ligjit të Statusit, për kandidatët për gjyqtarë të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, ndër ta edhe për z.{...}.

10. Institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet dhe raportimet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

11. Në vijim të procedurës së verifikimit, pas rishqyrtimit të dokumentacionit të kandidatit të dërguar nga Shkolla e Magjistraturës, u konstatua se në të mungonin vetëdeklarimet e kandidatit në lidhje me tre prej kritereve ligjore të përcaktuara në nenin 28 të Ligjit të Statusit. Konkretisht mungonin vetëdeklarimet në lidhje me anëtarësinë në parti politike, me disiplinën në punë (qenien ose jo i larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe për pasjen ose jo masë disiplinore në fuqi), si dhe me qenien ose jo bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete. Për këtë, me datë 07.10.2019, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidatit z. {...} në rrugë elektronike, iu dërguan formularët e vetëdeklarimeve që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej tij në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit.

12. Brenda afatit treditör, kandidati z. {...} depozitoi në zyrën përkatëse të Këshillit formularët përkatës të vetëdeklarimeve.

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT PËR KUSHTIN DHE KRITERET LIGJORE TË KANDIDIMIT PËR EMËRIM SI GJYQ TAR

A. Për kushtin e kandidimit/emërimit si gjyqtar

1. Sipas nenit 136/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë¹ dhe nenit 35, pika 1, shkronja “a” dhe “b”, të Ligjit të Statusit², për t’u emëruar gjyqtar kërkohet përfundimi i formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës dhe diplomimi, me të paktën 70 për qind të pikëve maksimale të mundshme, si dhe të jetë vlerësuar minimalisht “mirë” për të gjitha detyrat e dhëna gjatë stazhit profesional në vitin e tretë të formimit fillestar.

2. Bazuar në Vendimin nr.3, datë 01.07.2019, të Këshillit Pedagogjik të Shkollës së Magjistraturës, përcjell me Shkresën nr.625 prot., datë 03.07.2019, si dhe dokumentacionin e kandidatit {...},

¹ “1. Gjyqtarë mund të jenë shtetasit shqiptarë që emërohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, **pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës** dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës së tyre, sipas ligjit. 2. Kriteria të tjera për përzgjedhjen dhe emërimin e gjyqtarëve parashikohen me ligj”.

² “1. **I diplomuari** emërohet magjistrat nëse plotëson njëkohësisht këto kritere: a) është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, në formimin fillestar, më të paktën 70 për qind të pikëve maksimale të mundshme; b) është vlerësuar minimalisht “mirë” për të gjitha detyrat e dhëna gjatë stazhit profesional në vitin e tretë të formimit fillestar; ...”.

përcjell me Shkresën nr.635 prot., datë 04.07.2019, të Shkollës së Magjistraturës, konstatohet se kandidati në fjalë ka përfunduar programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës gjatë periudhës Tetor 2016 - Qershor 2019 dhe në përfundim të vitit akademik 2018 - 2019 është diplomuar për magjistrat, profili gjyqtar:

a) me 88.16 % të pikëve, pra *“është diplomuar me të paktën 70 për qind të pikëve maksimale të mundshme”*;

b) është vlerësuar me 600 pikë, domethënë “shumë mire”, për të gjitha detyrat e dhëna gjatë stazhit profesional në vitin e tretë të formimit fillestar, pra *“është vlerësuar minimalisht "mirë" për të gjitha detyrat e dhëna gjatë stazhit profesional në vitin e tretë të formimit fillestar”*.

3.Nga sa rezulton nga verifikimi, kandidati z.{...} plotëson kushtin e kandidimit/emërimit si gjyqtar.

B. Për kriteret e përgjithshme dhe të veçanta sipas nenit 28 të Ligjit të Statusit

1. Kriteret e parashikuara në nenin 28 të Ligjit të Statusit, përcaktohen si kriteret e pranimit në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, sikundër po ashtu, sipas neneve 64 dhe 66 të këtij ligji, ato përcaktohen edhe si kriteret zgjedhshmërie, pra si kriteret që magjistrati (gjyqtari) do të duhet t’i plotësojë gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të funksionit.

2. Verifikimi në këtë rast i kriterëve sipas nenit 28 të Ligjit të Statusit merr shkas nga fakti se kandidati z.{...} është pranuar në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës përpara hyrjes në fuqi të Ligjit të Statusit, por edhe të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, përmes të cilëve kanë pësuar ndryshime kriteret dhe rregullat e pranimit në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës dhe, me tej, edhe ato për emërimin e të diplomuarve në këtë shkollë për magjistratë.

3. Gjithsesi, në respektim të parimit të sigurisë juridike, në lidhje me verifikimin e kriterëve sipas nenit 28 të Ligjit të Statusit, u mbajt në konsideratë ligji i kohës së pranimit të kandidatit z.{...} në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, pra Ligji nr.8136, datë 31.07.1996, “Për Shkollën e Magjistraturës në Republikën e Shqipërisë” dhe Rregullorja e Brendshme e Shkollës së Magjistraturës dalë në zbatim të këtij ligji. Po ashtu u mbajt në konsideratë edhe ligji aktual në fuqi, pra Ligji i Statusit. Konsiderimi në këtë rast i rregullimeve sipas këtyre dy ligjeve konsiston në atë se vetëm për kriteret që nuk ka ndonjë përcaktim konkret në ligjin e kohës së pranimit në formimin fillestar, kandidati do të duhet të përmbush këto kriteret sipas ligjit aktual në fuqi.

4. Konkretisht, për kandidatin {...} u verifikuan këto kriteret:

a) *zotësia e plotë për të vepruar*. Për këtë kriter, ndërsa është verifikuar edhe në momentin e pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen apo kufizimin e saj me vendim gjyqësor të formës së prerë;

b) *shtetësia shqiptare*. Për këtë kriter, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidati ka depozituar dokumentin “Kartë Identiteti” (ID), lëshuar nga Ministria e Brendshme më datë 17.03.2009, ku pasqyrohet edhe përbërësi i gjendjes civile “shtetësia”, që në këtë rast pasqyrohet “shqiptare”. Ndërkohë, gjatë verifikimit nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen e shtetësisë shqiptare për këtë kandidat. Përkundrazi, nga verifikimi i bërë, më datë 15.10.2019, në regjistrin kombëtar elektronik të gjendjes civile të administruar nga Ministria e Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile), sipas certifikatës personale elektronike të printuar në letër nga nëpunësi i ngarkuar i Këshillit, konstatohet se kandidati vijon të ketë shtetësinë shqiptare;

c) *arsimimi*. Për këtë kriter, në rastin e pranimit në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, kandidati ka depozituar dokumentet: “Diplomë Bachelor në Juridik”, me nr. 309, datë 05.10.2012, lëshuar nga Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Fakulteti i Drejtësisë; Suplementi i Diplomës nr.35, lëshuar nga Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”; Vërtetim datë 18.09.2014, lëshuar nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë; Vërtetim Notash datë 18.09.2014, lëshuar nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë. Vlen të theksohet se, për këtë kriter mbahet në konsideratë verifikimi i bërë nga Shkolla e Magjistraturës në momentin e pranimit në provimin e pranimit për në formimin fillestar, sipas përcaktimeve të ligjit të kohës, pra sipas Ligjit nr.8136, datë 31.07.1996, “Për Shkollën e Magjistraturës në Republikën e Shqipërisë”;

ç) *gjendja gjyqësore*. Për këtë kriter, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kjo e fundit ka kryer verifikim në regjistrin elektronik gjyqësor të administruar nga Ministria e Drejtësisë (Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve) duke printuar në letër Certifikatë Elektronike datë 26.08.2016. Ndërkohë, gjatë verifikimit, në kuadër të verifikimit të figurës së kandidatit, u administrua Shkresa nr.V-2531/1 prot., datë 05.08.2019, e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (Sektori i Gjendjes Gjyqësore). Sipas këtyre dokumenteve, kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë;

d) *disiplina në punë*. Për këtë kriter, gjatë verifikimit, sipas informacionit të marrë nga kandidati, më datë 09.07.2019, ai nuk ka qenë ndonjëherë i punësuar. Gjithashtu, nga informacioni i marrë nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, me Shkresën nr. 5055/1 prot., datë 17.07.2019 dhe Shkresën nr. 7095 prot., datë 25.07.2019, nuk rezultoi ndonjë e dhënë për punësimin e këtij kandidati. Po ashtu, edhe nga informacioni i marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me Shkresën 13610/1 prot., datë 19.07.2019, nuk rezultoi ndonjë e dhënë për punësimin e këtij kandidati. Rrjedhimisht, për kandidatin nuk u identifikua dhe verifikua ndonjë e dhënë negative në lidhje me disiplinën në punë;

dh) anëtarësia në parti politike në kohën e kandidimit. Për këtë kriter, që përcaktohet si kriter zgjedhshmërie, pra edhe emërimi, sipas Ligjit të Statusit, gjatë verifikimit, kandidatit iu kërkua dhe ai depozitoi një deklaratë me shkrim në të cilën deklaroi se nuk është anëtar i ndonjë partie politike, ndërkohë që nuk u gjet ndonjë e dhënë për qenien e kandidatit anëtar i ndonjë partie politike;

e) qenia anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990. Për këtë kriter u mbajt në konsideratë mosha e kandidatit (i datëlindjes 19.08.1990), çka bën të panevojshëm verifikimin e këtij kriteri pranë autoritetit të ngarkuar nga ligji (Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit), sikurse përcaktohet edhe në pikën 8, Seksioni B, Kreu IX, të Vendimit 75/2019;

ë) qenia bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete. Për këtë kriter, që përcaktohet si kriter zgjedhshmërie, pra edhe emërimi, sipas Ligjit të Statusit, gjatë verifikimit, kandidatit iu kërkua dhe ai depozitoi një deklaratë me shkrim në të cilën deklaroi se nuk ka qenë dhe nuk është bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete, ndërkohë që gjatë verifikimit nuk u gjet ndonjë e dhënë për qenien e kandidatit bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete.

5. Sa i përket kriterit *të përvojës profesionale aktive me kohë të plotë, të paktën tre vjet*, sipas shkronjës “ç”, të nenit 28, të Ligjit të Statusit, ky kriter është i paaplikueshëm për këtë kandidat për shkak se nuk ka qenë kriter ligjor në kohën e kandidimit për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, ndërkohë që kandidati ka përfunduar programin e formimit fillestar dhe është diplomuar tashmë.

6. Nga sa rezulton nga verifikimi, kandidati z.{...} plotëson kriteret e kandidimit/emërimit si gjyqtar, sipas nenit 28 të Ligjit të Statusit.

C. Për kriterin e pasurisë

1. Për kandidatin {...} u verifikua kriteri i pasurisë, përcaktuar në pikën 1, të nenit 32, të Ligjit të Statusit.

2. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidatin {...}, u kërkua raportim nga ILDKPKI-ja, e cila ka dërguar në Këshillin e Lartë Gjyqësor Raportin nr. 60/26 prot., datë 10.09.2019.

2.1 Sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, kandidati {...} ka plotësuar dhe depozituar në afatin e caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor formularin e deklaratës së pasurisë, si dhe autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë.

2.2 Po ashtu, sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, nga kjo e fundit janë kryer kontrollet e plota për pasuritë, asetet dhe interesat e deklaruar nga kandidati {...}, duke konkluduar se për kandidatin:

- a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklaram të rremë;
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

3. Për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidatin {...} iu kërkua informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

3.1 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve informacioni u dërgua me Shkresën nr. 13610/1 prot., datë 19.07.2019, ku për kandidatin {...} nuk jepen të dhëna për aktivitete tregtare.

3.2 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave informacioni u dërgua me Shkresën nr. 18232/1 prot., datë 23.07.2019, ku për kandidatin {...} nuk jepet ndonjë e dhënë me karakter pasuror.

4. Të dhënat e dërguara përmes informacioneve respektive nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave u ballafaquan me të dhënat sipas Raportit të ILDKPKI-së, duke u vlerësuar se nuk kishte vend për t'iu kërkuar ILDKPKI-së bërja e një kontrolli shtesë.

5. Nga verifikimi i kriterit të pasurisë për kandidatin {...} janë grumbullur të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet se për të nuk ekziston asnjë prej shkaqeve të skualifikimit nga kandidimi dhe refuzimin e emërimit të tij si gjyqtar sa i përket kriterit të pasurisë. Konkretisht verifikohet që:

- a) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e deklaratës së pasurisë;
- b) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë;
- c) kandidati ka burime financiare për të justifikuar pasuritë e saj;
- ç) deklarimi nga kandidati i pasurisë, aseteve ose të interesave private, të detyrueshme për t'u deklaruar, është i plotë, i vërtetë dhe i saktë.

Ç. Për kriterin e figurës

1. Për kandidatin {...} u verifikua kriteri i figurës, përcaktuar në pikën 1, të nenit 32, të Ligjit të Statusit.

2. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidatin {...}, u kërkua raportim nga institucionet ligjzbatuese të përcaktuara në pikën 2, të nenit 32, të Ligjit të Statusit, me përjashtim të Byrosë Kombëtare të Hetimit, e cila nuk është ngritur ende.

3. Nga raportimet e shërbimeve shtetërore informative nuk u identifikua dhe verifikua ndonjë e dhënë për lidhje ose kontakte të papërshtatshme të kandidatit {...} me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo për përfshirjen e tij në veprimtari që cenojnë sigurinë kombëtare apo aktivite të kundërligjshme.

4. Po ashtu, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidatin {...}, atij iu kërkua dhe ai plotësoi e depozitoi rregullisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 11.07.2019, formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe autorizimin për Këshillin që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, të të dhënave të tij në lidhje me figurën dhe integritetin.

4.1 Në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Prokuroria e Përgjithshme ka kryer verifikimin përkatës, duke përcjell në Këshill, me Shkresën nr. 2057/97 prot., datë 14.10.2019, Vendimin “Për rezultatet e verifikimit për subjektin {...}”, sipas të cilit është vlerësuar se *“Subjekti deklarues {...}, kandidat për gjyqtar, i diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2018-2019, nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2, të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.*

4.2 Po në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile, me Shkresën nr. 6418/1 prot., datë 04.09.2019, ka dërguar në Këshill të dhënat për përbërësit e gjendjes civile edhe për kandidatin {...}, pas verifikimeve të bëra në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010 dhe në zyrat përkatëse të gjendjes civile.

4.2.1 Bazuar në informacionin e dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile, nëpunësi përgjegjës i strukturës së posaçme pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi kreu verifikimet e rastit, nuk konstatoi mangësi në të dhënat e deklaruara nga kandidati {...} në formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Për pasojë, u vlerësua që nuk kishte vend për verifikim shtesë nga Prokuroria e Përgjithshme.

5. Nga verifikimi i kriterit të figurës për kandidatin {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet se për të nuk ekziston asnjë prej shkaqeve të skualifikimit nga kandidimi dhe refuzimin e emërimit të tij si gjyqtar sa i përket kriterit të figurës. Konkretisht verifikohet që:

- a) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr.138/2015;
- b) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkuara, autorizimin për Këshillin e Lartë Gjyqësor që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, për të dhënat që lidhen me figurën dhe integritetin e saj;
- c) për kandidatin nuk ka të dhëna për lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar;
- ç) për kandidatin nuk ka të dhëna që të ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara datës 2 korrik 1991, në kuptimin e Ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- d) për kandidatin nuk ka të dhëna që të ketë qenë ose të jetë bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve të inteligjencës;
- dh) për kandidatin nuk ka ndonjë të dhënë tjetër në lidhje me figurën dhe integritetin e tij mbi të cilën të ngrihen dyshime për pranueshmërinë për emërim si gjyqtar.

III. KONKLUZIONE

1. Referuar përcaktimeve të Vendimit 75/2019, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatin z. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

2. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatin z. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidati i përmbush ato, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin dhe refuzimin e emërimit të tij si gjyqtar. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për kualifikimin e kandidatiy dhe vijimin e procedurës së emërimit të tij si gjyqtar.

PËR KETO ARSYE

Mbështetur në nenin 136/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 61, pika 2, shkronja “a” dhe nenin 97, pika 1, shkronja “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 35 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun VI, Seksioni Ç, pika 2, shkronja “b”, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

V E N D O S I

1. Të kualifikojë për emërim, kandidatin {...}, i diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2018 - 2019 dhe vijimin e procedurës së emërimit të tij si gjyqtar.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z.{...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR